

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ, Departamenti i Pergjithshem- Divizioni Civil, me gjyqtarin Enes Mehmeti, ne ceshtjen e inicuar me padine e paditesit [REDACTED] nga Ferizaj, te cilin e perfaqeson avokati [REDACTED] nga Prishtina, kunder te paditurës Kompanisa e Sigurimeve [REDACTED] S.H.A. Dega Kosovë në Prishtinë, per kompensimin e dëmit, me date 30.09.2016, jashte seance ka marre kete:

A K T G J Y K I M
-pa shqyrtim kryesor te ceshtjes -

- I. **REFUZOHET**, ne teresi si e pabazuar, kerkesepadia e paditesit [REDACTED] nga Ferizaji, me te cilin ka kerkuar qe te detyrohet e padituri t'ia kompensojë dëmin jo materiale, si pasoj e aksidentit të datës 18.01.2015, pasi që e paditura në bazë të marrveshjes jashtë gjyqësore të datës 14.08.2015 i'a ka kompensuar dëmin në shumë prej 5,682.00€.
- II. **OBLIGOHET** paditesi që të paguan taksën gjyqësore per padi dhe aktgjykim ne shume prej 30.00€ pas pranimit te ketij aktgjykimi, nen kercenimin e pasojave juridike.

A r s y e t i m i

Paditesi ka ushtruar padi kunder te paditurës, me pretendimin se per shkak te veprimeve deliktore te [REDACTED] i cili ka qenë i siguruar pranë të paditurës, gjatë pjesmarrjes në komunikacion ka shkaktuar aksident me datën 18.01.2015, ku nga ky aksident lendime te renda trupore ka pësuar paditesi. Paditesi në theksimet në padi ka theksuar se nga e paditura ka kërkuar që ti bëhet kompensim i demit material dhe jo material, mirëpo i njejt nuk ka arritur të arrij marrveshje jashtëgjyqësore me të paditurën.

Gjykata, pasi qe ka shqyrtuar shkresat e lendes, ka obliguar te paditurën qe te parashtrrojë përgjigje ne padine e paditesit. E paditura ne pergjigjen e saj ne padi, ka paraqitur prova te vlefshme, të cilat vërtetojnë theksimet e saj në përgjigje në padi, e cila është bazuar në Akt Marrveshjen per Pranimin e Vlerës së dëmit të kërkuar, që e paditura ka arritur me paditësin me datën me datën 14.08.2015 për kompensimin e dëmit, me anë të së cilës paditësit i ka bërë kompensim e të hollave në vlerë prej 5,682.00€. Andaj mbi kete baze nuk ekzistojn pretendimet e padise dhe per pasoje e njejta ka rezultuar si e pathemelt.

Nga sa u tha me siper eshte vendosur si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi duke u bazur ne nenet 152, 399 lidhur me 143 te LPK-se.

Per shpenzimet e procedures, gjykata ka vendosur ne baze te UA nr.2008/2 te KGJK-se, per unifikimin e taksave gjyqësore.

REPUBLIKA E KOSOVËS



REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHE
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE LOSNOVNI SUD
FERIZAJ II UROŠEVAC

C.nr.194/15, me datën 30.09.2016

Më
Dana

23
Dana



Gjyqtari,
Enes Mehmeti

KËSHILLË JURIDIKE: Kunder ketij aktgjykimi eshte e lejuar ankesa ne afat prej 15 ditesh, pas pranimit te tij, ne Gjykatën e Apelit ne Prishtine, perms kesaj Gjykate.